

URDHËR
Nr. 227, datë 6.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të gurmës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; germa “c”, e pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave z. Gentjan Mahmutaj, Koordinator për të Drejtën e Informimit në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së, për sa vijon:

- Për të nënshkruar kthim përgjigje, me karakter njohës dhe informues, dalëse të Drejtorisë së Përgjithshme, në lidhje me kërkesat për informacion drejtuar Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, në zbatim të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, që u drejtohen të tretëve (personat fizikë, personat juridike privat), si dhe ato të drejtuarara strukturave të varësisë së ASHK-së në funksion të informimit të të tretëve.

2. Pavarësisht delegimit të kompetencave sipas këtij urdhri, Koordinatori për të Drejtën e Informimit nëse e gjykon të nevojshme, mund t’i përcjellë për nënshkrim drejtorit të përgjithshëm shkresat që i vlerëson të një rëndësie të veçantë.

3. Delegimi i kompetencës sipas këtij urdhri nuk përfshin aktet administrative dhe detyrat të cilat duhet të miratohen dhe të ushtrohen nga drejtori i përgjithshëm, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

4. Në rast mungese në detyrë të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “c”, e Kodit të Procedurës Administrative. Gjatë mungesës kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.

5. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri, të ushtrohet duke filluar nga data e miratimit të këtij urdhri deri në shfuqizimin e tij.

6. Ngarkohet z. Gentjan Mahmutaj dhe Sektori i Arkiv-Protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli